MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINE E FINANCAVE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në **Ministrinë e Financave,** me objekt: *"Mbi zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011 dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomike dhe financiare, për periudhën 1/1/2011 deri më 31/12/2011"* dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 126, datë 06/09/2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 389/6 datë 06/09/2012 dërguar ***Z. Ridvan Bode, Ministër i Financave,*** krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Marrë shkas nga konstatimi që në harkun që rezultojnë në nivelet e 57.78% - 59.3% të PBB-së, pra shumë afër kufirit ligjor prej 60 % (risk zonë), si dhe me synim marrjen e masave parandaluese për ndryshimin e dinamikës së borxhit me tendencë uljeje të nivelit të tij, referuar praktikave të disa vendeve të Eurozonës, **rekomandojmë që**:
- *Nga Ministria e Financës, brenda dy viteve në vijim, të ndërrmeret iniciativa për hartimin e një plani veprimi për të propozuar amendime kushtetuese në të cilin të përcaktohet që "Borxhi total publik nuk duhet të tejkalojë limitin prej 60%".*
- *Po kështu me qëllim mos tejkalimin e këtij niveli, të studiohet mundësia e parashikimit të vendosjes së një pragu të nivelit të borxhit publik kundrejt PBB-së, përtej të cilit qeveria duhet të marre masa për balancimin e buxheteve.*

2. Konstatohet se në ligjet vjetore të buxhetit të vitit 2011, nuk janë vendosur kufijtë në lidhje me totalin e borxhit shtetëror dhe totalin e shumës së garancive sikurse përcakton neni nr. 58 "Kufijtë e borxhit publik" i ligjit nr. 9936, date 26/6/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".
Nga Ministria e Financave argumentohet se: "Në lidhje me percaktimin e kufijve të totalit të stokut të borxhit, përsëri jemi të mendimit se në kushtet e ndryshimit të kursit të kembimit rezultatet e stokut të borxhit janë të ndryshme dhe mund të sjellin **pasoja negative** për tregun e jashtem dhe të brendshëm si dhe në **perceptimin e kreditorëve për Shqipërinë**. Më pas këto interpretime vështiresojnë edhe me tej marrjen dhe sherbimin e borxhit duke dëmtuar financat publike dhe menaxhimin e tyre".

Për sa më sipër, **vlerësojmë si objektive,** komentet e bëra nga Ministria e Financave por meqenëse përcaktimi i kufijve të borxhit është *detyrim ligjor,* **rekomandojmë që:**
- Në ligjin "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2013" të përcaktohet kufiri për totalin e borxhit shtetëror dhe borxhit të garantuar, ndërkohë Ministria e Financave të ngrejë një grup pune për rishikimin e nenit 58 "Kufijtë e borxhit publik" të Ligjit nr. 9936, datë 26/6/2006.

3. Me synim rritjen e efektivitetit te menaxhimit të fondeve për shpenzime publike, **rekomandojmë që:**
- Në Udhëzimin plotësues që Ministri i Financave nxjerr çdo vit për zbatimin e buxhetit vjetor kapitulli I "Procedura specifike shtesë për zbatimin e buxhetit të shtetit "Detajimi i fondeve buxhetore" të shtohet si detyrim përfshirja në financimin e vitit "në radhë të parë" :
- Të gjitha investimet e kontraktuara, për punime të cilat rezultojnë të realizuara dhe nuk janë financuar për vitin ushtrimor si dhe atyre të cilave u mbaron afati kontraktual i punimeve në vitin që po programohet, për diferencën e punimeve të mbetura.
- Për projektet e investimeve "objekte të reja" të synohet në financimin e projekteve ne vlerën e plotë të projektit, kur vlera e tyre është e realizueshme brenda vitit buxhetor.

Menjëherë

4. Nga auditimi u konstatua se fondi i subvencionit i Ministrisë së Financave është alokuar nga fondi i Kontigjencës për ruajtjen e deficitit që në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011. Mbështetur në përcaktimet e ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetore në Republikën e Shqipërisë", si dhe ligjit vjetor të buxhetit, **rekomandojmë:**
- Planifikimin në ligjin vjetor të buxhetit të vitit 2013 dhe në vazhdim, nga Ministria e Financave, të fondeve kontigjencë për ruajtjen e deficitit buxhetor me të drejtë të përdorimit nga Kuvendi i Shqipërisë. E drejta e rialokimit të këtij fondi të përcaktohet nga Kuvendi, për përdorim nga Këshilli i Ministrave vetëm në fund të periudhës vjetore buxhetore, atëherë kur treguesit e realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve janë progresivisht, konform treguesve buxhetor të miratuar të vitit.

Menjëherë

5. Nga shqyrtimi i vendimeve të miratuara nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve " Për shpërndarjen e Fondeve të Zhvillimit të Rajoneve" është konstatuar që vendimet përmbajnë vetëm vlerën e alokuar në nivel projekti, për pasojë vendimet nuk japin një pamje të qartë të fondeve sa është vlera e plotë, sa janë alokuar

progresivisht deri në vitin buxhetor korrent, si dhe sa mbetet për tu alokuar në vitet e ardhshme.
Për sa më sipër**, rekomandojmë që:**
- Në aneksin nr. 3, të Ligjit "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2013" të vendoset detyrimi që: Vendimi i Komitetit te Zhvillimit të Rajoneve për detajimin e granteve konkurruese në nivel projekti duhet të përmbajë:
a) *Vlerën e plote të projektit për objektet e reja apo vlerën e kontratës së lidhur për objektet ne proces*.
b) *Vlerën e fondeve të alokuara dhe të realizuara deri në vitin korrent buxhetor.*
c) *Alokimin e fondit ne vitin korrent.*
d) *Vlerën e mbetur për buxhetim në periudhën pasardhëse.*

Vazhdimisht

6. Në drejtim të borxhit të garantuar u konstatua se mungojnë memorandumet e mirëkuptimit për marrëveshjet e garancive të lidhura nga Ministria e Financave. Me synim vendosjen e procedurave për realizimin e marrëdhënieve në funksion të zbatimit të nenit 38 " Dhënia e garancisë shtetërore të huas" dhe nenit 43 " Kthimi i garancisë shtetërore të huas" të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006" Për Huamarrjen Shtetërore, Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore të Huas në Republikën e Shqipërisë", sipas trajtimit të bërë në faqen nr. 66, të Raportit Përfundimtar të Auditimit**, rekomandojmë që:**
- Ministria e Financave t'i propozojë Këshillit të Ministrave *përmirësimin e ligjit nr. 9665, datë 18/12/2006, ku me nen të veçantë të përcaktohen kushtet dhe kriteret e specifikuara të marrëdhënieve të mirëkuptimit midis Ministrisë së Financave dhe përfituesit të garancisë,* duke i kthyer këto në detyrime ligjore dhe duke eliminuar në këtë mënyrë nënshkrimin e marrëveshjeve të veçanta, për të lehtësuar procesin e realizimit të marrëveshjeve të garancive, referuar zbatimit të këtyre detyrimeve ligjore.

Menjëherë

7. Nga auditimi u konstatua se nga Ministria e Financave për nevoja të huamarrjes gjatë vitit 2011, është rihapur ankandi nr.19 i obligacioneve 5 vjeçare, mbështetur kjo në të drejtën e rihapjes të këtyre ankandeve, përcaktuar në marrëveshjen e lidhur "Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi", mbështetur gjithashtu dhe në argumentimet e dhëna nga Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave mbi arsyet e rihapjes së ankandeve të obligacioneve, të cilat nuk janë të përfshira në marrëveshjen e mësipërme.
Sa më sipër**, rekomandojmë që:**

- Ministria e Financave në Bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë *të përcaktojnë në marrëveshjen "Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi", llojin e obligacionit që do të rihapet dhe kushtet që duhet të plotësojë një ankand obligacioni për tu rihapur*, për një menaxhim më efektiv të borxhit të brendshëm me instrumente afatgjatë.

Menjëherë

8. Për të saktësuar hapësirat e mundshme të huamarrjes nga Ministria e Financave të përcaktuara në marrëveshjen e përbashkët "Për Obligacionet", në varësi të nevojave për huamarrje me kosto sa më të ulët, për këtë **rekomandojmë që**:
- Nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave *të bëhet plotësimi i nenit 14, pika 2*, si më poshtë vijon:
"Nëqoftëse nga rezultatet fillestare të ankandeve të obligacioneve të cilat zhvillohen në një ditë rezulton se struktura e obligacioneve të kërkuara nga tregu është e ndryshme nga ajo e shpallur, Ministria vendos për pranimin e kërkesave duke mos e tejkaluar në asnjë rast shumën totale të obligacioneve të shpallura përpara ankandeve".

Menjëherë

9. Nga auditimi për disa vite i rregullshmërisë së përcaktimit dhe kalimit të "Fitimit neto të Bankës së Shqipërisë" në buxhetin e shtetit, **s**ipas kritereve të nenit 10, pika 2 e ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "*Për Bankën e Shqipërisë*", të ndryshuar, në të cilin përcaktohet: "*Fitimi neto për vitin financiar që mbetet pasi bëhen zbritjet, sipas neneve 8, 9 dhe të pikës 1 të këtij neni, kalon në të ardhurat e buxhetit të shtetit brenda 4 muajsh, pra deri më datën 30 prill të vitit pasardhës"* dhe të kritereve të marrëveshjes midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, lidhur më 27.03.2003, ku në pikën 4.2 të saj përcaktohet:"*Transferimi i fitimit të Bankës Shqipërisë, bëhet me kërkesë të Ministrisë së Financave dhe jo më shpejt se data 7 e çdo muaji në formë paradhënie. Transferimi do të fillojë në muajin shkurt dhe do të përfundojë në muajin janar të vitit pasardhës. Masa e fitimit të derdhur nuk do të tejkalojë vlerën 90 % të fitimit të realizuar"*, <u>kanë rezultuar</u>:
- Mangësi në zbatimin e aktmarrëveshjes për numrin e kalimeve të fitimit paradhënie;
- Mospërputhje midis neneve të ligjit dhe neneve të aktmarrëveshjes të sipërcituar, sepse ligji e përcakton shpërndarjen e fitimit, **pasi del rezultati vjetor** dhe pasi bëhen zbritjet, ndërsa akt marrëveshja, e përcakton kalimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë në buxhetin e shtetit çdo muaj të vitit, deri në 90% të fitimit të realizuar. Meqë rinovimi i aktmarrëveshjes ekzistuese ka filluar, por nuk është përmbyllur, **rekomandojmë që**:

- Rinovimi i aktmarrëveshjes ekzistuese midis dy institucioneve, të ketë parasysh përputhjen e neneve të ligjit nr. 8269, datë 23/12/1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të neneve të aktmarrëveshjes së lidhur midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, nene të cilat përcaktojnë transferimin e "Fitimit neto të Bankës së Shqipërisë" në llogarinë e "Depozitës së qeverisë".

Menjëherë

B. <u>MASA ORGANIZATIVE</u>

1. Marrë shkas nga konstatimi i shumave të konsiderueshme të papaguara nga huamarrësit dhe përfituesit e garancive, detyrime këto që deri në fund të vitit 2011, arrijnë në **shumën rreth 1.7 miliardë lekë**, referuar dhe problematikës së shfaqur nga ujësjellësit të rezultuara në vazhdimësi këto vitet e fundit, të konkluduara në raportet e paraqitura në vazhdimësi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, mungesës së zgjidhjes së këtyre problematikave, pavarësisht takimeve të shumta nga struktura përkatëse të Ministrisë së Financave, me institucionet përgjegjëse, për këtë, **rekomandojmë që:**

- Mbështetur në ligjin nr. 10294, datë 1.07.2010 "Për Inspektimin Financiar Publik" në nenin 2; nenin 3; nenin 4/pika 1,4,6,8,13; nenin 7; nenin 8/pika 2.ç; nenin 9, propozojmë **kryerjen e inspektimeve financiare** për ndërmarrjet e ujësjellsave, përfituese të nenhuave dhe garancive për zgjidhjen e problematikave në lidhje me :

a) Dokumentacionin, inventarizimin dhe kontabilizimin e përfitimeve nga projektet.

b) Menaxhimin e fondeve publike në drejtim të rezultateve financiare, të cilat kanë rezultuar në paaftësi paguese të njësisë në shuma të konsiderueshme.

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet KLSH-së dhe Ministrisë së Financave, nëse Ministria e Financave e gjykon të arsyeshme dhe të nevojshme, *mund edhe KLSH të kontribuojë në këtë drejtim.*

2. Referuar problematikës së vazhdueshme që paraqet raportimi i financimeve të huaja, ku janë konstatuar parregullsi, vonesa të shumta në raportimet e institucioneve dhe mos raportime nga disa njësi të zbatimit të projekteve, për këtë **rekomandojmë që:**

- Në përputhje me pikën 6 të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 17/2/2003 "Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj" dhe pikën "e" të nenit 71 "Kundërvajtjet administrative" të Ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ministria e Financave, të procedojë me masa administrative për punonjësit përgjegjës të

institucioneve që nuk raportojnë për projektet e tyre brenda afateve ligjore të përcaktuara.

Vazhdimisht

3. Nga auditimi rezultoi se nuk janë paraqitur në Ministrinë e Financave shumë raportime nga Njësitë e Zbatimit të Projekteve, pavarësisht se të dhënat për projektet që ato menaxhojnë janë përmbledhur në raportin e ministrive të linjës nga të cilat ato varen. Për këtë, **rekomandojmë që:**

- Në zbatim të pikës 4.1 "Transaksionet" të udhëzimit nr. 8, datë 17/2/2003, çdo projekt me financim të huaj, pjesë e ligjit të buxhetit të vitit në vazhdim, të ketë raportim të veçantë në Ministrinë e Financave.

Vazhdimisht

4. Referuar konstatimit se në Ministrinë e Financave nuk ka monitorim "hap pas hapi" të procesit të njoftimit për zhvillimin e ankandeve për titujt e Qeverisë në një media kombëtare dhe në një gazetë kombëtare dhe duke e konsideruar këtë proces shumë të rëndësishëm për publikun në procesin e huamarrjes. Për këtë, **rekomandojmë që:**

- Në urdhrin vjetor të Ministrit të Financave për përcaktimin e strukturave përgjegjëse në procesin e publikimit të njoftimeve për ankandet e bonove dhe të obligacioneve, të përcaktohet gjithashtu dhe struktura përgjegjëse për monitorimin e njoftimit në mënyrën " hap pas hapi".

Menjëherë

5. Bazuar në germën "e" të nenit 16 të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", për mbikëqyerjen dhe vlerësimin e strukturave audituese në përputhje me standardet dhe kërkesat e manualit, **rekomandojmë që:**

- Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, si strukturë që mbikëqyr dhe monitoron veprimtarinë e strukturave audituese, për të siguruar zbatimin e standarteve dhe cilësinë e punës audituese, të hartojë një metodikë për kontrollin e jashtëm të cilësisë dhe vlerësimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik .

Për vitin në vijim, nëse Ministria e Financave e gjykon të nevojshme, KLSH është gati të bashkëpunojë në këtë fushë, me ekipe të përbashkëta në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet KLSH-së dhe Ministrisë së Financave.

Deri më 31/12/2012

6. Nisur nga fakti se, sistemi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit vlerësohet si sistem me risk të lartë dhe se, auditimi i këtij sistemi është ende larg zbatimit të tijë, pasi ka mungesë të theksuar të njohurive, apo të kapaciteteve për kryerjen e auditimeve të IT, për këtë **rekomandojmë që**, në të ardhmen Njësia

Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në bashkëpunim me njësitë audituese të subjekteve publike, duke aktivizuar ekspertë të specializuar të fushës të plotësojnë nevojat për trajnime në këtë fushë.

Vazhdimisht

7. Nga auditimi kanë rezultuar njësi audituese që, në programin e tyre të punës nuk përfshihet auditimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, siç është rasti i trajtimit në Raportin Final të Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, për Institucionin e Prefektit të Qarkut të Korçës, ku njësia audituese e këtij institucioni në programet e punës për subjektet e audituara nga kjo njësi, nuk është përfshirë auditimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm. Për këtë, **rekomandojmë që:**

- Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm të marrë masa dhe të tërheqë vëmendjen, njësive audituese që në programin e tyre të auditimit, të përfshijnë dhe auditimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Vazhdimisht

8. Nga auditimi i materialeve, mbi raportimet e subjekteve për auditimet e vitit 2011, rezulton se, megjithë përmirësimet në zbatimin e rekomandimeve të lëna, akoma niveli i zbatimit të tyre është 63.2%, madje një pjesë e tyre nuk zbatohen pasi, nuk janë bindëse për menaxherin.

Për këtë, **rekomandojmë që:**

- Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm të intensifikojë punën nëpërmjet edukimit profesional të përditësuar me audituesit, duke u fokusuar dhe organizuar "trajnime në praktike" për zbatimin e udhëzimeve e praktikave me te mira te standardeve ndërkombëtare të auditimit "për punën ne terren", "dokumentimin" dhe "raportimin" për një vlerësim më të saktë të gjetjeve, për paraqitjen e argumenteve rast pas rasti, me qëllim ndërgjegjësimin e strukturave menaxheriale përgjegjëse, për shkeljet dhe veprimet e parregullta.

Vazhdimisht

9. Duke marrë shkas nga konstatimi se në disa njësi shpenzuese, nëpunësit zbatues nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në kuadrin rregullator ligjor të Menaxhimit financiar dhe kontrollit (arsimimi) dhe (linjat e raportimit), si në rastin e disa komunave në qarqet e Shkodrës dhe Korçës, ku nëpunësit zbatues rezultojnë me profesionin "Mjek veteriner", "Mësues cikli i ulet" apo "punonjës me arsim te mesëm" etj. Për këtë, **rekomandojmë që:**

a) Nga Nëpunësi i Parë Autorizues në bashkëpunim me Njësinë Qëndrore të Harmonizimit të MFK-së, të kërkohet nga Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme marrja e informacionit për nëpunësin zbatues nga ana e njësive shpenzuese për

arsimimin, specialitetin si dhe linjat e raportimit ne raport me nëpunësin autorizues të njësisë shpenzuese.

Deri më 30 Shtator 2012

b) Për të gjitha rastet e konstatimit në kundërshtim me kriteret e përcaktuara të njoftohen titullarët e njësive shpenzuese që të marrin masa për zbatimin e procedurave për emërimin e nëpunësve zbatues sipas kritereve ligjore brenda një periudhe tranzitore e diferencuar sipas rastit por limiti përfundimtar kohor të jete 31.12.2012, në rast të kundërt të bllokohen veprimet në thesar të këtyre punonjësve.

Menjëherë

10. Marrë shkas nga konstatimi që në raportin "Mbi monitorimin e realizimit të shpenzimeve të vitit 2011" i cili është pjesë e raportit që Ministria e Financave ka dërguar në Këshillin e Ministrave " Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2011" treguesit e realizimit të shpenzimeve të Ministrive të linjës nuk përmbajnë shpenzimet faktike të financuara nga të ardhurat jashtë limitit apo edhe nga financimi i huaj si dhe për rrjedhojë këto raporte nuk rakordojnë me raportet të konsoliduara të Ministrisë së Financave për shpenzimet faktike, për këtë, **rekomandojmë që**:

- Nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit t'i kërkohet Ministrive të linjës që në raportet e monitorimit në një rubrikë të veçantë të trajtohen shpenzimet faktike te kryera për të ardhurat jashtë limitit apo edhe mospërputhjet e financimit të huaj.

Menjëherë

11. Nga auditimi rezultoi se në Ministrinë e Financave, nëpunësi autorizues ka caktuar si nëpunës zbatues të institucionit Drejtoreshën e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, të cilës i ka deleguar edhe funksionin e koordinatorit të riskut. Kjo Drejtori sipas strukturës së përcaktuar të Ministrisë së Financave ka varësi direkte nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse dhe jo nga nëpunësi autorizues. Po kështu nëpunësi i parë autorizues, është caktuar edhe si nëpunës autorizues i kësaj Ministrie.

Sa më lart, **rekomandojmë që:**

- Ministria e Financave të rishikojë strukturën e saj organizative si dhe strukturën menaxheriale, për të reflektuar linjat e raportimit në përputhje me Ligjin nr.10296, datë 8/7/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Menjëherë

12. Nga auditimi për disa vite i llogarisë *"Depozitë e Qeverisë"*, kanë rezultuar diferenca në mbajtjen dhe kontabilizimin e saj midis dy institucioneve, pra midis mbajtjes dhe kontabilizimit të saj në Ministrinë e Financave dhe kontabilizimin e

mbajtjes së saj në Bankën e Shqipërisë, duke reflektuar diferenca si në gjendjen e kësaj llogarie dhe diferenca në zërat e të ardhurave apo shpenzimeve të kaluara nga kjo llogari.
Për këtë vit janë vërejtur mangësi të:
- Kohës së konfirmimit të evidencës së nxjerrjes së kësaj llogarie nga Ministria e Financave dhe konfirmimi nga Banka e Shqipërisë, duke e vonuar përgjigjen e konfirmimit edhe 3 muaj;
- Mënyrës së raportimit të gjendjes së kësaj llogarie, duke nxjerrë tabela me zëra dhe shuma të ndryshme shpenzimesh apo të ardhurash, kaluar nga kjo llogari në zëra si: "Sistemime për diferencat e Bankave të nivelit të dytë", "Debitorë për financimin e Buxhetit", "Garanci të tjera të vitit në vazhdim", "Interesa nga projektet", "Të ardhura të tjera", "Kontributi për përmbytjet", "Diferencë Cash-Accrual".
Për këtë, ***rekomandojmë,*** standartizimin e zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe standardizimin e formatit të rakordimit nga dy institucionet që rregjistrojnë llogarinë "Depozitë e Qeverisë", me synim eliminimin e diferencave në rakordimin e zërave si në shpenzime dhe në të ardhurat që kalojnë nga kjo llogari.

Menjëherë

13. Të merren masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna në kontrollin e mëparshëm por që nga verifikimi i tyre rezultuan të pazbatuara ose në process zbatimi.

Menjëherë

14. Nga auditimi i zbatimit të vendimeve gjyqësore apo vendime të Komisionit të Shërbimit Civil rezultoi se nga ana e Ministrisë së Financave këto vendime janë zbatuar në mënyrë të pjesshme pra: nuk është kthyer punonjësi në vendin e punës por është zbatuar pjesa vendimeve që ka të bëjë me pagesën e pagës së këtyre punonjësve deri në momentin e kthimit në vendin e punës. U konstatua se këta punonjës nuk janë kthyer në vendin e punës sikurse përcaktojnë vendimet, për rrjedhojë janë paguar dhe vazhdojnë të paguhen vendime gjyqësore apo vendime të KSHC-së .
Sa më sipër, **rekomandojmë që:**
- Të merren masa për zbatimin e vendimeve gjyqësore, të analizohet e të nxirret përgjegjësia ndaj personave shkaktarë, duke ndjekur procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Luljeta Nano Përgjegjës Grupi, Nërënxa Llapashtica, Nikoleta Piranian, Evis Çela, Vasil Vane, Qeram Cibaku, Rajmond Koçi, Aleksander Tereziu dhe Fadil Dekovi. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT